




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Data/Date/Datum:	06.06.2022
Për/To/Za:	Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)
Përmes/Through/Preko:	Doruntina Hasani – Kryesuese e Komisionit për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit
Nga/From/Od:	Alban Hyseni – Kryetar i Komunës së Gjilanit
Lënda/Subject/Tema:	Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës për Vitin 2021

Të nderuar/a,

Bazuar në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, lidhur me Auditimin për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2021, brenda afatit të përcaktuar sipas Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 23, paragrafi 5, ju lutem gjeni të bashkangjitur Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së, të përgatitur nga Komisioni i themeluar sipas Vendimit me nr. 02/449, të dt. 20.05.2022.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALE KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
7. 06. 2022			
Kopje/ Copy Org. J. Sh. Org. Unit	Char. Klasif. Klasif. Kind Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. f. faqesh Br. Stranica No. Pages
04	47	917	7



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

---

ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA/MAYOR'S OFFICE/BASKAN OFISI

---

**PËR:**

Zyra Kombëtare e Auditimit

**NGA:**

Alban Hyseni - Kryetar i Komunës së Gjilanit

**LËNDA:**

Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës për Vitin 2021

Gjilan,  
Qershor 2022

Nr. rendor	Gjetja/Çështja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara	Zyrtari/ët Përgjegjës	Data e planifikimit të zbatimit të rekomandimit
1	A1 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontigjente ne PFV	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për detyrimet kontigjente në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë	1) Kontrollimi/Verifikimi i evidencave të lëndëve lidhur me obligimet kontigjente 2) Rritja e kontrollit të brendshëm dhe koordinimi për verifikimin e të dhënave lidhur me detyrimet kontigjente	Zyra e Avokatit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Tashmë ka filluar së zbatuari ky rekomandim
2	B1 – Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate	1) Planifikimi i shpenzimeve sipas ndarjeve të buxhetit 2) Ridestnimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve përkatëse ekonomike	Të gjithë zyrtarët e autorizuar në kuadër të Drejtorive	Në vazhdimësi
3	A2 – Përdorimi i gabuar i procedurës së prokurimit	Kryetari duhet të siguroj se aplikon procedurat e duhura të prokurimit ashtu siç parashihet me kërkesat ligjore, duke siguruar se procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë të përdoret në rrethana të arsyeshme sipas	1) Rritja e kontrollit të brendshëm për zbatimin e procedurave të duhura të prokurimit 2) Aplikimi i procedurës së negociimit pa publikim vetëm në	Zyra e Prokurimit	Menjëherë dhe në vazhdimësi

		LPP	rrethana të arsyeshme		
4	A3 – Tejkalim i kontratës publike kornizë	Kryetari duhet të shtoj kontrollat për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikqyrje e mirëfilltë e kontratave publike kornizë me çmim për njësi në mënyrë që të mos bëhet tejklimi i tyre	1) Rritja e kontrollit të brendshëm me qëllim të mbikqyrjes së mirëfilltë të kontratave 2) Ndarja e përgjegjësisë së mbikqyrjes së kontratave në më shumë zyrtarë	Zyra e Prokurimit dhe të njësitë kërkuese	Menjëherë dhe në vazhdimësi
5	A4 – Subvencionimi i OJQ-së pa bërë thirrje publike	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve do të respektohen kërkesat e dala nga rregullorja, ashtu që për mbështetje financiare për OJQ-të të bëhet thirrje publike.	Ndërmarrja e të gjitha veprimeve të përcaktuara sipas Rregullores MF-nr-0/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit për OJQ-të me rastin e subvencionimit të OJQ-ve	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Shëndetësisë	Menjëherë dhe në vazhdimësi
6	A5 – Pagesa e kryer për shërbimet e pa kontraktuara	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratave publike kornizë fillimisht të bëjë një analizë të mirëfilltë të nevojave reale, në mënyrë që gjatë ekzekutimit mos të kryhen shërbime apo pozicione që nuk kanë qenë të përfshira në specifikacionin e kontraktuar	1) Rritja e kontrollit të brendshëm për mbikqyrje të kontratave publike kornizë 2) Analizë përpara inicimit të procedurave të prokurimit	Të gjitha Drejtoritë Komunale	Menjëherë dhe në vazhdimësi
7	A6 – Mangësi lidhur me marrëveshjet për shërbime të	Kryetari të siguroj se me rastin e angazhimit të	Respektimi i kriterëve dhe procedurave sipas	Zyra e Kryetarit	Menjëherë dhe në vazhdimësi

	veçanta	personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respektohen kriteret sipas legjislacionit përkatës	legjislacionit në fuqi, lidhur me angazhimin e stafit		
8	B2 – Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës financiare	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Respektimi i hapave për procedim të pagesave sipas legjislacionit të aplikueshëm në fuqi	Të gjithë zyrtarët e autorizuar në kuadër të Drejtorive.	Menjëherë dhe në vazhdimësi
9	B3 – Dobësi në definimin e sasive në kontratat publike kornizë	Kryetari duhet të siguroj që para fillimit të procedurave të prokurimit dhe hyrjes në obligime kontraktuale përmes kontratave kornizë, nevojat të vlerësohen saktë dhe të siguroj se menaxherët e kontratës ushtrojnë kontrole të rregullta për furnizime të çdo artikulli sipas kontratës kornizë dhe nuk bëjnë tejkalim të sasive të kontraktuara	1) Analizë përpara inicimit të procedurave të prokurimit për vlerësimin e nevojave 2) Respektimi i procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi 3) Rritja e kontrollit ndaj menaxherëve të kontratës me qëllim që të mos tejkalohen sasitë e kontraktuara	Zyra e Prokurimit, Drejtorët e Drejtorive dhe Menaxherët e Kontratave	Menjëherë dhe në vazhdimësi
10	B4 – Dobësi në regjistrimin e pasurive kapitale	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e drejt të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejt të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare	1) Zbatimi i dispozitave ligjore të aplikueshme lidhur me regjistrimin e drejt të pasurisë jo-financiare kapitale 2) Rritja e kontrollit të brendshëm 3) Vendosija e përfituesve në SIMFK	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Qershor 2022 – Gusht 2022

			4) Përgatitja e kërkesës për anulimin e pasurive në Ministrinë e Financave – Departamenti i Thesarit		
11	C1 – Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara	Kryetari duhet të siguroj shlyerjen e obligimeve të papaguara për shpronësim. Para se të vendos për shpronësimin e tokave, të bëjë një analizë të mirëfilltë për të siguruar se do të ketë mjete të mjaftueshme buxhetore për ti mbuluar të gjitha shpenzimet e parapara të shpronësimit	1) Themelimi i grupit punues për verifikimin në terren të borxheve të këqija 2) Prioritet i jepet lëndëve që kanë arritur formën e plotfuqishme në procedurë përmbarimore 3) Themelimi i Fondit të Mirëbesimit për realizimin e pagesave për shpronësim lidhur me projektin e impiantit të ujërave të zeza	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë	Gusht 2022 – Dhjetor 2024
12	A7 – Mosverifikimi i plotë i pronave komunale	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor	1) Shtimi i kontrollit të brendshëm dhe rritja e përqindjes së verifikimit të pronave 2) Rritja e angazhimit të stafit për verifikimin e pronave	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Qershor 2022 – Dhjetor 2022
13	B5 – Inicimi i projekteve pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve	Kryetari duhet të forcoj kontrollat gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar	1) Përgatitja e planit të prokurimit 2) Analizë për	Zyra e Kryetarit dhe të gjitha Drejtoritë Komunale	Nga tani e tutje

		që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim	sigurimin e fondeve lidhur me zhvillimin e projekteve, përpara inicimit të procedurave të prokurimit		
14	B6 – Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme	1) Organizimi i takimeve individuale me borxhlinjtë e mëdhenjë mbi 10,000 euro, për të negociuar arritjen e marrëveshjes së pagesës së obligimeve me këste 2) Organizimin e takimeve grupore me tatimpaguesit prej 1-10,000 euro 3) Thirrje publike për tatimpaguesit që kanë borxhe prej 300-1,000 euro, që të shfrytëzojnë mundësinë e arritjes së marrëveshjes me Komunën e Gjilanit për pagesë të borxheve deri në 24 këste.	Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim	Qershor 2022 – Nëntor 2022

Datë: 06.06.2022  
Gjilan

Kryetari i Komunës:

  
Alban Hyseni